

LIGJ
Nr. 15/2017

PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj:

- a) përcakton parimet themelore të ofrimit, qeverisjes, financimit dhe menaxhimit të arsimit dhe të formimit profesional (AFP);
- b) rregullon aspektet e sistemit të AFP-së në përputhje me sistemin e përgjithshëm arsimor dhe tregun e punës;
- c) përcakton misionin dhe objektivat kryesorë të sistemit të AFP-së, si dhe rregullat për krijimin, organizimin, administrimin, financimin dhe mbylljen e ofruesve të AFP-së;
- ç) përcakton rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve publike dhe subjektet e tjera përgjegjëse për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aspekteve të AFP-së.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të krijojë dhe të zhvillojë një sistem të njësuar të AFP-së që t'u përgjigjet ndryshimeve social-ekonomike dhe teknologjike, në përputhje të plotë me nevojat e tregut vendas e global të punës;
- b) të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit dhe garantimit të cilësisë në institucionet e arsimit profesional, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;
- c) të modernizojë sistemin e AFP-së, duke e bërë atë një mekanizëm më efektiv dhe më të efektshëm për rritjen e ritmeve të zhvillimit të ekonomisë e të shoqërisë shqiptare, duke siguruar pajtueshmërinë e tij me sistemin arsimor dhe tregun e punës;
- ç) të garantojë mundësi të barabarta për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në AFP.

Neni 3

Misioni i AFP-së

Arsimi dhe formimi profesional ka për mision:

- a) të zhvillojë kompetenca personale e profesionale të nevojshme, si dhe shprehi e kompetenca të tjera të diversifikuara, që pasqyrojnë preferencat dhe nevojat e veçanta të punëdhënësve për të siguruar mirëqenie sociale dhe zhvillimin ekonomik;
- b) të ofrojë arsim dhe formim profesional në përputhje me nivelin e zhvillimit të shkencës e të

* Ligji nr. 15/2017, datë 16.2.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 43, date 9 mars 2017.

teknologjisë, me kërkesat e tregut të punës në ndryshim të vazhdueshëm, si dhe me kulturën e traditën kombëtare;

c) të sigurojë përputhshmëri ndërkombëtare të dokumenteve certifikuese të lëshuara.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ministria përgjegjëse për AFP-në” është ministria që ka në fushën e saj të përgjegjësisë çështjet e AFP-së.

2. “Këshilli Kombëtar i AFP-së” është organi këshillimor që krijohet dhe funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për AFP-në.

3. “Arsimi dhe formimi profesional (AFP)” është një fushë e aftësive profesionale, që kombinon arsimin me praktikën profesionale, e cila i pajis individët me njohuri e shprehje të veçanta, si dhe me kompetenca të gjera që kërkohen për t’u punësuar në një profesion të caktuar dhe për t’u integruar në tregun e punës.

4. “Sistemi i AFP-së” është sistemi, ku përfshihen të gjithë përbërësit e AFP-së dhe institucionet, të cilat e mbështesin atë, përfshirë dhe ofruesit e AFP-së.

5. “Ofrues i AFP-së” është institucioni publik ose jopublik (person fizik ose juridik), i licencuar dhe/ose i akredituar për të ofruar programe/ shërbime të AFP-së në Republikën e Shqipërisë.

6. “Rezultatet e të nxënimit” është një grup njohurish, shprehish dhe/ose kompetencash, që një individ i ka fituar dhe/ose është në gjendje t’i demonstrojë pas përfundimit të procesit të të mësuarit formal, joformal ose informal.

7. “Forma e dyfishtë e AFP-së” është një lloj i ofrimit të arsimit dhe formimit profesional, i cili kombinon kualifikimin në një institucion të AFP-së me punën dhe aftësimin praktik në ndërmarrje, në bazë të përcaktimeve të një marrëveshjeje ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit (nxënësit) dhe ofruesit të AFP-së.

8. “Njësia e zhvillimit” është struktura e brendshme e ofruesit të AFP-së, e cila planifikon dhe realizon veprimtari zhvillimore në mbështetje të ngritjes së kapaciteteve të brendshme dhe rritjes së cilësisë.

9. “Kualifikimi profesional” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat mundësojnë ushtrimin me sukses të një aktiviteti të caktuar profesional, i cili mund të përftohet nëpërmjet mësimnxënies te një ofrues i AFP-së, i përmbyllur me provime dhe i certifikuar nëpërmjet një dokumenti përkatës (certifikatë).

10. “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK)” është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh për nivele specifike të të nxënimit të përfutur, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit e të cilësisë së kualifikimeve që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile.

11. “Të nxënimit” është procesi, nëpërmjet të cilit një individ përvetëson njohuri dhe zhvillon qëndrime, vlera dhe kompetenca.

12. “Të nxënimit formal” është procesi i planifikuar, i organizuar dhe i institucionalizuar i të nxënimit, i shoqëruar me certifikata të njohura zyrtarisht nga një autoritet kombëtar.

13. “Të nxënimit joformal” është mësimnxënia që përfshihet në aktivitete të planifikuara dhe jo domosdoshmërisht të zhvilluara si forma mësimore në aspektin e objektivave mësimore, kohës dhe

mbështetjes mësimore.

14. “Të nxënit informal” është procesi i paplanifikuar, i paorganizuar dhe i painstitucionalizuar i të nxënit, i cili nuk shoqërohet me certifikata të njohura zyrtarisht nga një autoritet kombëtar.

15. “Njohja e të nxënit të mëparshëm” është procesi i mësimnxënies, nëpërmjet të cilit rezultatet e të nxënit të një individi njihen zyrtarisht si aftësi dhe kompetenca, si nëpërmjet dhënies së një kualifikimi në formën e një certifikate, diplome apo titulli, ashtu edhe nëpërmjet dhënies së ekuivalencës, njësive të krediteve, vleftësimit të aftësive dhe/ose kompetencave të fituara.

16. “Të nxënit gjatë gjithë jetës” është i gjithë aktiviteti i mësimnxënies i fituar gjatë jetës, i cili çon në përmirësimin e njohurive, shprehive, aftësive, kompetencave dhe/ose kualifikimeve për arsye personale, shoqërore dhe/ose profesionale.

17. “Certifikatat/dëshmitë/diplomat” janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

18. “Partnerët sociale” janë organizatat e punëdhënësve e të punëmarrësve që përfaqësojnë, sipas dispozitave të Kodit të Punës, të dyja anët e dialogut social dhe marrin pjesë e kontribuojnë në zhvillimin e sistemit të AFP-së.

19. “Qendra Shumëfunktionale e AFP-së” është një ofrues i arsimit dhe formimit profesional, që ka mandatin ligjor dhe kapacitetin për të ofruar arsim profesional të mesëm dhe pas të mesmes, si dhe formim profesional për të rinjtë e të rriturit.

20. “Korniza Europiane Referuese për Sigurimin e Cilësisë në AFP” përmban një cikël sigurimi dhe përmirësimi të planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe rishikimit të AFP-së, që mbështetet nga kriteret e përbashkëta të cilësisë, përshkruarit indikativ dhe treguesit.

21. “Akreditimi” është njohja formale që një institucion mund të kryejë detyrat për të cilat është licencuar. Akreditimi i një ofruesi të AFP-së është procesi i sigurimit të cilësisë së ofruesit që tregon se institucioni është i miratuar nga autoritetet përkatëse dhe që ka përmbushur standarde të paracaktuara.

22. “Sigurimi i cilësisë” është tërësia e aktiviteteve të planifikuara, të zbatuara, të vlerësuara e të raportuara, të cilat garantojnë që AFP-ja (përmbajtja e programeve, kurrikulat, vlerësimi dhe vleftësimi i rezultateve të të nxënit) është në përputhje me kriteret e cilësisë.

23. “Lista Kombëtare e Profesioneve” klasifikon profesionet, bazuar në llojin e punës e në kompetencat e nevojshme dhe përbëhet nga emërtimet përkatëse të profesioneve/punëve e nga përshkrimet e profesioneve.

24. “Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve” është institucioni publik përgjegjës për krijimin e sistemit të unifikuar të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar, bazuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe për kualifikimin e trajnimin e vazhduar të mësuesve/instrukturëve të arsimit profesional.

Neni 5

Parimet

Sistemi i AFP-së bazohet në këto parime themelore:

a) Parimi i gjithëpërfshirjes: Sistemi i AFP-së ofron mundësi arsimimi dhe formimi profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim.

b) Parimi i autonomisë: Sistemi i AFP-së funksionon në bazë të autonomisë qeverisëse dhe financiare të ofruesve të AFP-së.

c) Parimi i cilësisë: Sistemi i AFP-së siguron cilësinë, sipas standardeve të miratuara e të përputhura me standardet ndërkombëtare për njohjen e kualifikimeve e të rezultateve të të nxënit.

ç) Parimi i bashkëpunimit: Sistemi i AFP-së funksionon në bazë të bashkëpunimit me subjekte të ndryshme publike dhe jopublike dhe në veçanti me partnerët socialë, të cilët janë të përfshirë

në të gjitha nivelet e sistemit të AFP-së.

d) Parimi i garantimit të pjesëmarrjes: Sistemi i AFP-së krijon kushtet financiare, fizike dhe shoqërore për individët për të përfituar nga mundësitë e të nxënësve gjatë gjithë jetës.

dh) Parimi i mobilitetit dhe vijueshmërisë: Sistemi i AFP-së garanton përputhjen e kurrikulave të lëndëve të arsimit të përgjithshëm që përfshihen në profilet e tij. Ai ofron mundësi për të gjithë nxënësit për t'u transferuar në programe të tjera arsimit ose formimit dhe/ose për të vazhduar me marrjen e njohurive, kompetencave dhe aftësive, në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

e) Parimi i diversitetit: Sistemi i AFP-së ofron lloje dhe nivele të shumëllojshme të kualifikimeve, të përshtatura për grupe të ndryshme, duke njohur njohuritë e tyre të përftuara më parë.

KREU II PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE

Neni 6

Kuadri institucional i sistemit të AFP-së

1. Sistemi i AFP-së përbëhet dhe administrohet nga institucione publike dhe jopublike që veprojnë në nivel qendror dhe vendor, përfshirë edhe ofruesit e AFP-së.

2. Autoritetet publike punojnë në partneritet me partnerët socialë dhe aktorë kryesorë të tjerë.

3. Ministria përgjegjëse për AFP-në, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve janë institucionet kryesore përgjegjëse për AFP-në në Shqipëri.

4. Roli i këtyre institucioneve, në kuadër të sistemit të AFP-së, përcaktohet nga ky ligj dhe nga aktet përkatëse nënligjore.

Neni 7

Ministria përgjegjëse për AFP-në

Ministria përgjegjëse për AFP-në ka këto kompetenca:

a) harton politika në fushën e AFP-së, si dhe monitoron zbatimin e tyre;

b) harton dhe propozon bazën ligjore e nënligjore në fushën e AFP-së;

c) monitoron dhe garanton cilësinë në sistemin e AFP-së;

ç) siguron burimet e nevojshme njerëzore, financiare e logjistike për funksionimin e AFP-së;

d) bashkëpunon me partnerët socialë në fushën e AFP-së;

dh) koordinon bashkëpunimin me institucione të tjera qendrore, të cilat janë përgjegjëse për aspekte të veçanta të AFP-së;

e) miraton hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e ofruesve publikë të AFP-së, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

ë) bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Biznesit në procesin e licencimit të ofruesve privatë të AFP-së;

f) miraton hapjen dhe mbylljen e programeve, bazuar në kualifikimet kombëtare, të ofruara nga ofruesit publikë të AFP-së;

g) miraton procedurat për njohjen e njohurive të mëparshme;

gj) koordinon partnerët vendorë e ndër-kombëtarë që veprojnë dhe kontribuojnë në fushën e AFP-së;

- h) miraton dokumentet themelore të kualifikimeve profesionale kombëtare;
- i) përcakton procedurat për njohjen e mësimnxënies dhe kualifikimeve profesionale të niveleve 2 deri në nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, përfshirë ato të përfuara jashtë vendit;
- j) përcakton procedurat për njohjen e kualifikimeve profesionale për profesione të rregulluara, sipas direktivave të Bashkimit Europian.

Neni 8

Kompetencat e ministrisë përgjegjëse për arsimin e përgjithshëm

Ministria përgjegjëse për arsimin e përgjithshëm ka këto kompetenca:

- a) miraton programet e kulturës së përgjithshme në bazë të kompetencave kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës;
- b) organizon testimin dhe certifikimin e lëndëve përkatëse të Maturës Shtetërore Profesionale, nëpërmjet institucioneve të specializuara;
- c) organizon aftësimin e vazhdueshëm profesional për mësuesit e kulturës së përgjithshme që janë të angazhuar në AFP;
- ç) përcakton kriteret e përgjithshme për kualifikimin e mësuesve të lëndëve të arsimit të përgjithshëm në AFP.

Neni 9

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

1. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, veç detyrave të tjera të përcaktuara nga ligje të tjera, është përgjegjëse për aspektet e menaxhimit që lidhen me ofruesit publikë të AFP-së.
2. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është e ngarkuar me mbajtjen e një regjistri me certifikatat përfundimtare dhe me suplementet e certifikatave të lëshuara nga ofruesit e AFP-së dhe kryerjen e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve të AFP-së.
3. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

1. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve ka këto kompetenca:
 - a) harton dhe mirëmban Listën Kombëtare të Profesioneve;
 - b) harton dhe mirëmban Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale për nivelet 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
 - c) harton programet kombëtare dhe materiale mbështetëse për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
 - ç) harton programet e kurseve të unifikuara të formimit profesional publik;
 - d) monitoron kualifikimin e vazhduar të personelit mësimdhënës të kulturës profesionale të ofruesve të AFP-së;
 - dh) harton standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të AFP-së;
 - e) akrediton ofruesit e AFP-së për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së;
 - ë) përcakton kriteret e vlerësimit dhe certifikimit për nxënësit në sistemin e AFP-së.
2. Organizimi dhe veprimtaria e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Këshilli Kombëtar i AFP-së

1. Këshilli Kombëtar i AFP-së është organ këshillimor që krijohet dhe funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për AFP-në.

2. Përbërja, funksionimi dhe fusha e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të AFP-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Funksionet, kriteret e anëtarësimit dhe modalitetet e punës vendosen bashkërisht nga të gjithë partnerët dhe përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Ofruesit e AFP-së

1. AFP-ja ofrohet nga institucionet publike dhe private.

2. Institucionet ofruese të AFP-së janë:

a) shkollat e mesme profesionale;

b) qendrat shumëfunktionale të AFP-së;

c) qendrat e formimit profesional;

ç) institucionet e specializuara të AFP-së për grupet e veçanta;

d) shoqëritë tregtare;

dh) institucionet e tjera të licencuara dhe/ose të akredituara ose individët.

3. Ofruesit e AFP-së ofrojnë shërbimet e mëposhtme:

a) programe të arsimit dhe formimit profesional për të rinjtë dhe të rriturit;

b) trajnim sipas kërkesës për ndërmarrjet;

c) trajnim për aftësitë bazë, trajnim për kompetencat specifike kyçe;

ç) njohjen e të nxëniet të mëparshëm;

d) shërbime të tjera që lidhen me profilin e ofruesit.

4. Mënyra e organizimit dhe veprimtaria e institucioneve të AFP-së, përfshirë aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të ofruesve të AFP-së dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të AFP-së, rregullohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

Neni 13

Bordi Drejtues i ofruesve publikë të AFP-së

1. Bordi Drejtues i ofruesve publikë të AFP-së është një organ kolegjal, i cili merr vendime për drejtimin e përgjithshëm strategjik, planifikimin e përgjithshëm dhe përdorimin e burimeve njerëzore, financiare, materiale e fizike dhe mbështetjen e aktivitetit të administrimit të ofruesve publikë të AFP-së, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

2. Bordi përbëhet nga përfaqësues të sektorit publik dhe privat:

a) dy përfaqësues të sektorit privat që lidhet me profilin e institucionit të AFP-së;

b) një përfaqësues i njësisë arsimore vendore (drejtorisë rajonale/zyrës arsimore), që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së (shkollat publike profesionale);

c) një përfaqësues i këshillit të qarkut, që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së;

ç) një përfaqësues i zyrës rajonale/vendore të punësimit, që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së;

d) një përfaqësues i personelit mësimdhënës të institucionit publik, ofrues të AFP-së;

dh) një përfaqësues i nxënësve për shkollat publike të arsimit profesional ose një përfaqësues i punëmarrësve për qendrat publike të formimit profesional.

3. Bordi zgjedh kryetarin prej anëtarëve përfaqësues të sektorit privat.
4. Kriteret për pjesëmarrjen, organizimin dhe funksionimin e Bordit Drejtues të ofruesve publikë të AFP-së përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

Neni 14

Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e ofruesve publikë dhe jopublikë të AFP-së

1. Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e ofruesve publikë të AFP-së bëhen me urdhër të ministrit përgjegjës për AFP-në.
2. Hapja dhe mbyllja e ofruesve jopublikë bëhet me miratimin e ministrit përgjegjës për AFP-në.

Neni 15

Njësia e zhvillimit të ofruesit të AFP-së

1. Çdo ofrues i AFP-së ka njësi zhvillimi.
2. Njësia e zhvillimit ka këto funksione:
 - a) zhvillimin e vazhduar profesional të mësim-dhënësve brenda institucionit;
 - b) zhvillimin e kurrikulave në nivel ofruesi;
 - c) krijimin e lidhjeve ndërmjet ofruesit dhe biznesit;
 - ç) orientimin për karrierë të nxënësve/ kursantëve;
 - d) hartimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore;
 - dh) zhvillimin e marketingut të ofruesit;
 - e) mbledhjen e të dhënave të gjurmimit në nivel ofruesi.
3. Përbërja e njësisë së zhvillimit të ofruesit të AFP-së përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në, siç përcaktohet në nenin 12, pika 4, të këtij ligji.

KREU III

PËRMBAJTJA E AFP-së

Neni 16

Kualifikimet profesionale dhe nivelet përkatëse

1. Përfitimi, njohja dhe certifikimi i kualifikimeve profesionale në Shqipëri bazohet në standardet e kualifikimeve, të cilat përmbajnë njohuritë, shprehjet dhe kompetencat që duhet të arrijë nxënësi ose kursanti.
2. Kualifikimet profesionale përmbajnë nivelet 2, 3, 4 dhe 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).
3. Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përfitohen nëpërmjet këtyre formave:
 - a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
 - b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
 - c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
 - ç) njohjes të të nxënësve të mëparshëm informal dhe joformal;
 - d) njohjes të të nxënësve të përfutur jashtë vendit;
 - dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

4. AFP-ja fillon pas përfundimit të arsimit bazë, ofrohet nga institucionet ofruese të AFP dhe është me kohëzgjatje 2 - 4-vjeçare. Sistemi i arsimit profesional ofron nivelet e mëposhtme:

a) Me përfundimin e arsimit profesional bazë, i orientuar sipas drejtimeve të gjera profesionale, me kohëzgjatje 2 vite shkollore pas përfundimit të arsimit bazë, mund të përftohet niveli 2 i KSHK-së. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë të përgatitjes bazë profesionale dhe lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional ose në tregun e punës.

b) Me përfundimin e arsimit profesional, i orientuar sipas profileve profesionale për çdo drejtim profesional, me kohëzgjatje 2 vite shkollore, mund të përftohet niveli 3 dhe 4 i KSHK-së, pas përfundimit të arsimit profesional bazë. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatën e punëtorit të kualifikuar, teknikut/menaxherit në profesionin përkatës dhe/ose me diplomën e maturës shtetërore profesionale, si dhe lejon kalimin në tregun e punës e në arsimin e lartë.

Neni 17

Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale

1. Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale përmban emërtimet, standardet dhe dokumente të tjera kombëtare përkatëse për secilin kualifikim, në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat.

2. Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale miratohet nga ministri përgjegjës për AFP-në.

Neni 18

Lista Kombëtare e Profesioneve

1. Lista Kombëtare e Profesioneve hartohet dhe rishikohet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në bashkëpunim me partnerët socialë.

2. Lista Kombëtare e Profesioneve miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Kurrikulat dhe programet e AFP-së

1. Kurrikulat e kualifikimeve profesionale të nivelit 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ndërtohen në formën e kurrikulave kombëtare, të cilat hartohen nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe më pas detajohen dhe zhvillohen në formën e kurrikulave në nivelin e ofruesit të AFP-së.

2. Formatet dhe procedurat kurrikulare të AFP-së përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

Neni 20

Transferimi horizontal dhe vertikal

1. Sistemi i AFP-së lejon transferimin horizontal dhe vertikal të përfituesve të AFP-së.

2. Transferimi horizontal i përfituesve të arsimit dhe formimit profesional konsiston në transferimin e përfituesit nga një drejtim/shkollë në një drejtim/shkollë tjetër.

3. Transferimi vertikal i përfituesve të arsimit dhe formimit profesional konsiston në transferimin e përfituesit nga arsimi i mesëm profesional në arsimin pas të mesëm.

4. Kushtet dhe procedurat për transferimin horizontal dhe vertikal brenda sistemit të AFP-së përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

5. Kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimi i përgjithshëm në arsimin profesional dhe anasjelltas përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për AFP-në dhe të ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit.

Neni 21

Njohja e të nxënit të mëparshëm

1. Kompetencat e përfutuara nga arsimi dhe formimi profesional joformal dhe informal vlerësohen në përputhje me standardet e profesioneve për kualifikimet profesionale.
2. Procedurat e vlerësimit e të certifikimit miratohen nga ministri përgjegjës për AFP-në.
3. Në rastet e individëve që kanë marrë një certifikatë, diplomë apo titull jashtë vendit, njësimi kryhet nga ministria përgjegjëse për AFP-në, në bazë të rregullave të miratuara nga ministri përgjegjës për AFP-në.
4. Sistemi i njohjes të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Forma e dyfishtë e AFP-së

1. Forma e dyfishtë e AFP-së ofrohet në bashkëpunim ndërmjet punëdhënësve dhe institucioneve përgjegjëse për AFP-në.
2. Mjedisi kryesor për përfutimin e kualifikimit profesional është vendi i punës, në bazë të një kontrate ndërmjet punëdhënësit dhe nxënësit (punëmarrësit), në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.
3. Ofruesit e AFP-së ofrojnë mundësinë për plotësimin e kualifikimit profesional të nxënësit.
4. Kualifikimet afatgjata, të përfutuara nëpërmjet formës së dyfishtë të AFP-së, janë pjesë e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
5. Për kualifikimet profesionale, të përfutuara në fushën e veprimtarisë së zejeve, vlejnjë dispozitat e ligjit të zejeve.

Neni 23

Këshillimi dhe orientimi i karrierës

Sistemi i AFP-së ofron shërbime për udhëzimin, këshillimin dhe orientimin e karrierës së nxënësve dhe kursantëve të vet për të lehtësuar punësimin e tyre, në bazë të rregullave të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për AFP-në.

KREU IV

SIGURIMI I CILËSISË

Neni 24

Sistemi i sigurimit të cilësisë

1. Sigurimi i cilësisë është një proces i vazhdueshëm që synon të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të AFP-së. Ai përfshin licencimin, akreditimin dhe inspektimin e ofruesve të AFP-së, vetëvlerësimin, monitorimin dhe raportimin nga ofruesit e AFP-së, si dhe një vlerësim në intervale të caktuara të të gjithë sistemit të AFP-së nëpërmjet institucionit përkatës për AFP-në.
2. Procedurat për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve rregullohen me ligjin për KSHK-në.

Neni 25

Akreditimi

1. Akreditimi është një procedurë sistematike, së cilës i nënshtrohen ofruesit publikë të AFP-së. Ofruesit jopublikë të AFP-së i nënshtrohen një procesi akreditimi vetëm në rast se ofrojnë formim profesional për kualifikimet, të cilat shoqërohen me certifikatë të njohur nga ministria përgjegjëse për AFP-në dhe/ose kur aplikojnë për fonde publike.

2. Standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të AFP-së hartohen nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe miratohen nga ministria përgjegjëse për AFP-në.

Neni 26

Inspektimi

1. Inspektimi i ofruesve të AFP-së kryhet nga ministria përgjegjëse për AFP-në.
2. Inspektimi i aspekteve të kulturës së përgjithshme realizohet nga struktura përkatëse përgjegjëse për arsimin e përgjithshëm.
3. Dokumentacioni, procedura dhe kriteret për kryerjen e inspektimeve shtetërore të sistemit të AFP-së rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

Sistemi kombëtar i informacionit për AFP-në

1. Sistemi kombëtar i informacionit për AFP-në zhvillohet dhe mirëmbahet nga ministria përgjegjëse për AFP-në dhe agjencitë zbatuese.
2. Raportimi dhe publikimi i të dhënave zyrtare statistikore për sistemin e AFP-së është përgjegjësi e ministrisë përgjegjëse për AFP-në, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave.

KREU V

VLERËSIMI, PROVIMET DHE CERTIFIKIMI

Neni 28

Vlerësimi dhe provimet në AFP

1. Vlerësimet dhe provimet kryhen për të përcaktuar nëse rezultatet e të nxënit, të shprehura në formën e njohurive, shprehive dhe sjelljeve, kanë arritur standardet e parashikuara.
2. Llojet dhe standardet e vlerësimit, përfshirë kriteret, procedurat, udhëzimet dhe kërkesat minimale, janë të rregulluara nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në bashkëpunim me partnerët socialë, dhe të miratuara nga ministri përgjegjës për AFP-në.
3. Një nxënës i ri apo i rritur i nënshtrohet një provimi për marrjen e një kualifikimi profesional në një nivel të caktuar të KSHK-së, pas përfundimit të arsimit profesional, teorik dhe praktik, sipas formës së veçantë të ofrimit të AFP-së.
4. Komisionet e provimeve përfshijnë përfaqësues të biznesit apo ekspertë me përvojë teorike e praktike në fushën profesionale në fjalë, sipas rregullave të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për AFP-në.
5. Në përfundim të nivelit 4 të KSHK-së, nxënësi merr Maturën Shtetërore Profesionale.
6. Organizimi dhe zhvillimi i provimeve në AFP rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

Neni 29

Certifikimi

1. Certifikata e kualifikimit profesional i lëshohet një individ, i cili i ka përmbushur standardet përkatëse të kualifikimit, pas një procesi vlerësimi formal.
2. Dokumentet e certifikimit lëshohen nga ofruesi i AFP-së.
3. Çdo certifikatë përfundimtare zyrtare në AFP shoqërohet nga një suplement i certifikatës, duke ndjekur udhëzimet e miratuara në BE dhe duke përshkruar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e përfutuara nga mbajtësi i certifikatës.

4. Llojet, procedurat dhe mënyrat për lëshimin e certifikatave, si dhe formatet që do të përdoren rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

KREU VI FINANCIMI

Neni 30

Burimet e financimit

1. Arsimit dhe formimi profesional publik financohen nga:
 - a) Buxheti i Shtetit;
 - b) të ardhurat e gjeneruara nga vetë ofruesit publikë të AFP-së;
 - c) kontributet e donatorëve;
 - ç) sponsorizimet.
2. Mënyra e financimit nga Buxheti i Shtetit përcaktohet sipas procedurave ligjore në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për AFP-në dhe Ministrin të Financave.
3. Të ardhurat e gjeneruara nga ofruesit e arsimit dhe formimit profesional publik administrohen në masën 100 për qind nga vetë institucioni i arsimit dhe formimit profesional. Mënyra e gjenerimit dhe e shpenzimit të tyre përcaktohet sipas parashikimeve të udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për AFP-në dhe Ministrin të Financave.

Neni 31

Aktivitetet fitimprurëse të ofruesve publikë të AFP-së

1. Ofruesit publikë të AFP-së funksionojnë si njësi ekonomike për të siguruar të ardhura nga aktivitetet e praktikave mësimore. Ata kanë të drejtë të investojnë dhe të riinvestojnë të gjitha të ardhurat e përftuara nga aktivitetet e tyre të ligjshme sipas rregullave të miratuara nga ministri përgjegjës për AFP-në.
2. Të ardhurat e ofruesve të AFP-së përfshijnë:
 - a) të ardhurat nga oferta e AFP-së, bazuar në kontrata të nënshkruara me të tretë;
 - b) të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve dhe i mallrave në treg;
 - c) të ardhurat nga dhënia me qira e mjediseve dhe pajisjeve, bazuar në kontrata qiraje ose kontrata të tjera;
 - ç) fondet kombëtare dhe të projekteve të financuara nga donatorë ndërkombëtarë sipas projekteve;
 - d) të ardhura të tjera që lejohen me ligj.
3. Të ardhurat e lartpërmendura janë në përputhje me qëllimet e institucionit, lidhen me profilet e ofruara dhe me qëllimet sociale dhe nuk duhet të përbëjnë qëllim fitimi në vetvete.

Neni 32

Alokimi i Buxhetit të Shtetit për ofruesit e AFP-së

1. Alokimi i Buxhetit të Shtetit për ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional bëhet bazuar në parashikimet për shpenzimet e personelit, përfshirë pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, shpërblimet për performancë të mirë dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, shpenzimet operative përfshirë mallrat e konsumit, riparimet, shpenzimet e tjera operative për zhvillimin e praktikës dhe teorisë profesionale, aktivitete ekstrakurrikulare dhe funksionimin e institucionit, si edhe investimet, përfshirë ndërtimin dhe rindërtimin e ndërtesave, blerjen e pajisjeve të mëdha dhe veprimtari të tjera të lidhura me to.

2. Bursa është financimi monetar që jepet për të mbështetur arsimimin e një nxënësi për arritjet mësimore të tij ose sipas kriterëve të tjera, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Llojet e bursave janë: bursat e studimit për nxënësit me arritje mësimore, bursat e studimit për nxënësit që ndjekin drejtime profesionale që janë prioritet kombëtar ose vendor, bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë. Masa, kriteret e përfundimit dhe procedurat e dhënies së bursave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Pushteti vendor mund të ofrojë bursa për të ndjekur AFP-në në bashki të tjera në profile që përputhen me prioritetet vendore, sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për pushtetin vendor.

KREU VII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 33 **Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 34 **Dispozita kalimtare**

Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, do të zbatohen deri në miratimin e akteve nënligjore të parashikuara në nenin 35 të këtij ligji.

Neni 35 **Miratimi i akteve nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, shkronja “e”; 9, pika 3; 10, pika 2; 11, pikat 2 e 3; 18, pika 2; 21, pika 4; 26, pika 3; dhe 32, pika 1, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për AFP-në që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12, pika 4; 13, pika 4; 15, pika 3; 17, pika 2; 19, pika 2; 20, pika 4; 21, pika 2; 25, pika 2; 28, pikat 4 e 6; dhe 29, pika 4, të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për AFP-në dhe Ministri i Financave që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin akte nënligjore në zbatim të nenit 30, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji.

4. Ngarkohen ministri përgjegjës për AFP-në dhe ministri përgjegjës për çështjet e arsimit që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin akte nënligjore në zbatim të nenit 20, pika 5, të këtij ligji.

5. Ngarkohet ministri përgjegjës për pushtetin vendor që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 32, pika 3, të këtij ligji.

Neni 36 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.2.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10057, datë 6.3.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

